

A keni të drejtë ankese?

Nëse nuk pajtoheni me vendimin e lëshuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC), ju keni të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës. Vendimet përfundimtare të KPCC-së, apo në rast të ankesës, vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, janë detyruese dhe të zbatueshme dhe nuk do të shqyrtohen nga asnjë organ gjyqësor apo administrativ në Kosovë.

KPA do të implementojë vendimin e marrë nga KPCC-ja apo në rast të ankesës nga Gjykata Supreme e Kosovës.

A keni nevojë për ndihmë të mëtutjeshme?

Nëse dëshironi të dini më tepër rreth të drejtave tuaja, apo keni nevojë për ndihmë për t'u bërë palë në kërkesë ju mund të kontaktoni cilëndo zyre të KPA-së. Agjencia ka caktuar stafin që do të jetë në gjendje t'ju ndihmojë juve.

Mënyra të tjera për të vërtetuar nëse është paraqitur kërkesë për pronën në KPA:

Lista e kërkesave të paraqitura në KPA regullisht publikohet dhe është në dispozicion në të gjitha komunat dhe gjykatat vendore.

Po ashtu, kërkesat për prona mund t'i kërkonit elektronikisht në web-faqen:

<http://www.kpaonline.org/SearchSC/frmSearch.aspx>

Ju lutem, vëreni se ekziston një vonesë kohore në publikimin e listave të pronave të kërkuara, prandaj kërkesa për pronë mund të jetë paraqitur edhe nëse ajo nuk gjendet në këto lista.

Beograd

"Kosovska" - 49/8
Tel: 011 334 5513, ose 334 5314 Fax: 011 334 4452

Gjilan

"Rade Popovic"/"Washington Street"
Tel: 0280 320 289 - fax: 0280 324 067

Kragujevc

9, "Llolla Ribar" Rr. Kati 3-të
Tel: 034 330-234; 330-784

Mitrovicë

Pjesa jugore: "Mbretëresha Teuta" (përballë Jugobankës)
028 530 136 and 530 137 - fax: 028 530 139
Pjesa veriore: "Filip Vishnjq" Nr. 4, Dhoma Nr. 18 (ish-Ndërtesa e AKM-së), Stacioni Verior i Policisë
Tel: 063 197 6470 - fax: 028 530 139

Nish

"Dusanov Bazar" (Dusanova) Kati 3-të, Zyrja Nr. 308
Tel: 018 515-727; 515-728

Pejë

"Mbretëresha Teuta", Nr. 85
Tel: 039 431 668, 039 432 968
fax: 039 432 970

Podgoricë

"Crnogorskih Serdara"
Tel: 081 624 216

Prishtinë

Qendër: "Rexhep Luci" 28/"Goleshit" 2 Tel: 038 225 473 - fax: 038 244 854
Graçanicë: Prapa ndërtesës së komunës
Tel: 038 225 473

Prizren

"Jeronim De Rada" (ish-Zef Mark Lushi/Metohisë) Nr. 63/A
Tel: 038 504 604 8046/8024 - fax: 029 631 429

Shkup

"Vinička", Nr. 10 (ndërtesa CDRIM),
kati i 1-rë
Tel: +389 22 656 291

E PËRKRAHUR NGA



mailbox@kpaonline.org



Agjencia Kosovare e Pronës



Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) është themeluar më 4 mars 2006 dhe ka kompetenca ekskluzive, që i nënshtrohet ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës, për të zgjidhur kërkesat për pronën e paluajtshme private që rrjedhin si pasojë e konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999.

Çka do të thotë nëse ju pranoni fletënjoftim nga KPA-ja?

Nëse ju pranoni fletënjoftim nga KPA-ja rreth kërkesës, kjo do të thotë që dikush tjetër kërkon të ketë të drejtë juridike në pronën të cilën momentalisht jeni duke e shfrytëzuar.

Ju lutemi, të jeni në dijeni me faktin që edhe nëse dikush tjetër ka paraqitur kërkesë për pronë, kjo automatikisht nuk do të thotë që ai/ajo ka të drejtë pronësie.

Çka duhet të bëni nëse pranoni fletënjoftimin rreth kërkesës nga KPA-ja?

Nëse keni pranuar fletënjoftimin nga KPA-ja që një kërkesë është paraqitur për pronën të cilën ju tani jeni duke e shfrytëzuar dhe/apo besoni se ju keni të drejta pronësore, ju duhet të kontaktoni ndonjë zyre të KPA-së brenda 30 ditëve pas marrjes së fletënjoftimit, nëse dëshironi të kontestoni kërkesën dhe/apo të bëheni palë në kërkesë.



Çka do të thotë të bëhesh palë në kërkesë?

Duke u bërë palë në kërkesë ju do të keni të drejtën të paraqitni informata, dokumentacion, dhe dëshmi KPA-së për të dëshmuar që ju jeni pronar apo keni të drejtë ligjore në pronën e kërkuar. Ju gjithashtu do të njoftoheni rreth përpunimit të mëtutjeshëm të kërkesës. Përveç kësaj, ju do të keni të drejtë të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit që do të lëshohet nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KPCC) nëse nuk pajtoheni me vendimin.

Duke u bërë palë, ju do të merrni statusin si "palë përgjegjëse" në kërkesë.

Çka duhet të ndërmerri që të bëheni palë në kërkesë?

Për të kontestuar kërkesën dhe/apo të bëheni palë në kërkesë ju duhet të paraqitni formularin Njoftim mbi Pjesëmarrjen në cilëndo zyre tonën brenda 30 ditëve pas pranimit të fletënjoftimit. Të gjitha zyrat e KPA-së kanë zyrtarë, të cilët mund t'ju ndihmojnë në plotësimin e formularit.

Cilat dokumente duhet t'i paraqitni?

Nëse dëshironi të kontestoni kërkesën ju duhet t'i ofroni KPA-së dokumentet, të cilat dëshmojnë të drejtat tuaja mbi pronën. Këto dokumente përfshijnë :

- Kontratën mbi Shitblerjen;
- Fletën e Posedimit;
- Vendimin e Gjykatës mbi përcaktimin e të drejtave në pronën e patundshme;
- Deklaratën e nënshkruar nga shitësi apo dëshmitari;
- Kopjen e Planit Kadastral;

- Certifikatën kadastrale apo dokumentet e tjera kadastrale;
- Vendimin mbi Ndarjen;
- Kontratën mbi Shfrytëzim;
- Marrëveshjen mbi Qiranë;
- Vendimin mbi Trashëgiminë në rast se bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur;
- Faturat e shërbimeve Komunale;
- Të dhënat mbi Tatimet;
- Lejen e përkohshme, të lëshuar nga autoriteti publik, apo bartësi i së drejtës pronësore;
- Çdo dokument tjetër që dëshmon të drejtën tuaj pronësore.

Çka ndodh më tutje?

30 ditë pas njoftimit tuaj mbi kërkesën, KPA do të fillojë të përpunojë kërkesën. KPA do të hetojë të gjitha informatat e dhëna nga ju si "palë përgjegjëse" dhe nga pala tjetër që ka paraqitur kërkesë për pronën (paraqitësi i kërkesës). Kjo përfshinë verifikimin e dokumenteve të paraqitura nga të gjitha palët. Përveç kësaj, KPA mund të kontrollojë në të dhënat publike pronësore.

Në momentin që kërkesa pronësore hetohet në tërësi, ajo do t'i dorëzohet Komisionit të Pavarur për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC). KPCC do të marrë vendim duke pranuar apo refuzuar kërkesën e paraqitur nga "paraqitësi i kërkesës".